



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*  
*Centralna Izborna Komisija*  
*Central Election Commission*



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

## **Komunikatë**

**07. 08. 2013**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbajti mbledhjen e 40-të të cilën, e kryesoi znj. Valdete Daka, kryetare e KQZ-së. Para se të miratohej rendi i ditës, Bajram Ljatifi, anëtar i KQZ, kërkoi që lidhur me panelin për zgjedhjen e Zëvendëskryeshefit, informata të bëhet në formë raporti. Alban Krasniqi, anëtar i KQZ-së, kërkoi që si pikë e rendit të ditës, të jetë aktiviteti i kryetares Daka lidhur me heqjen e Formularit për Votim Jashtë Vendi, dhe për shkuarjet në Bruksel. Kryetarja, Valdete Daka, tha se, edhe për raportin e, edhe për heqjen e formularëve do t'i japë shpjegimet e nevojshme.

Pas miratimit të rendit të ditës, me propozimet e bëra, Kryeshefi i SKQZ-së, Enis Halimi e informoi KQZ-në lidhur me zbatimin e afateve të Planit Operacional. Nga data 25.07.2013, deri më datën 07.08.2013, ka filluar periudha e Shërbimit të Votuesve: prej 06.08.2013. Njësia e Shërbimit të Votuesve, i ka përgatitur listat Preliminare të Votuesve dhe listat Preliminare të Votuesve që janë ndarë në bazë të çdo lokacioni të Qendrave të Votimit. Kërkesa e bërë Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, ka pasuar me aprovimin e linjën speciale telefonike pa pagesë për nevoja të votuesve gjatë periudhës së shërbimit të votuesve, përfshirë edhe ditën e zgjedhjeve. Linja telefonike e aprovuar na autoriteti është (0) 800 55 555. Njësia e Shërbimit të Votuesve në kuadër të Periudhës së Regjistrimit për Votim Jashtë Kosovës, i ka dërguar pakot me aplikacione Pikave Shpërndarëse. Njësia e Shërbimit Votues, nga data 27 korrik 2013, e deri më tani, ka pranuar shtatë (7) aplikacione për regjistrim. Në kuadër të Njesisë së Shërbimit të Votuesve, është bërë rekrutimi i stafit jo – permanent, konkretisht Zyrtarë të Listës së Votuesve dhe Zyrtarë të Votimit Jashtë Kosovës.

Njësia e Shërbimit të votuesve gjatë kësaj jave do të përgatis një Program Orientues për zyrtarët e rekrutuar. Programi orientues do të përmban informata lidhur me periudhën e Regjistrimit për votim jashtë Kosovës dhe Periudhën e Votimit. Gjithashtu, janë realizuar edhe këto aktivitete: Pranimi i kërkesave dhe pagesat me para të imëta, përgatitja e avansit dhe tërheqja e mjeteve për udhëtim zyrtar të kryetares znj. Valdete Daka në Bruksel, si dhe sigurimi i biletës së udhëtimit me aeroplan, përgatitja e UOP dhe dokumentacionit tjetër përcjellës për pagesa me modul të blerjeve dhe të aprovimit, mbyllja e avansit të udhëtimit zyrtar për vëzhgimin e Zgjedhjeve në Shqipëri, përgatitja e lëndëve për pagesë si zotimi i mjeteve dhe shpenzimi i tyre, përgatitja e materialeve për mbledhjen e 12-të të Këshillit për Buxhet dhe Prokurim, tërheqja dhe shpërndarja e mbushjeve për Stafin e KQZ-së, SKQZ-ne dhe ZLKZ-te për muajin korrik 2013, pagesa e pagave për muajin korrik të zyrtareve të grupeve parlamentare (GP), pranimi i lëndëve nga GP dhe pagesa e tyre, procedimi dhe transferimi i mjeteve financiare për muajt gusht dhe shtator për subjektet politike, Përgatitja e ndryshimeve në sistemin e pagave në bazë të vendimeve nr. 457-2013 dhe 458-2013 të datës 31.07.2013, konform organogramit të ri të aprovuar, përgatitja, organizimi dhe mbajtja e intervistave me gojë, si dhe përzgjedhja e kandidateve për pozitat jo permanente, përgatitja e kontratave – marrëveshjeve të veçanta për stafin jo permanent, mbajtja e evidencës për ardhje- vajtje e stafit të SKQZ-se, furnizimi me material administrativ në bazë të kërkesave të ZLKZ dhe përgatitjet për shpërndarjen e tij, kompletimi i zyres së RPPC dhe Listës Votuese me inventar dhe kompjuter, Akomodimi i zyrtarve të SKQZ-së në dy zyret e Prokurorisë së Shtetit, specifikimi i materialeve zgjedhore, si: material administrativ, kuti votimi, kabina votimi, UV sprej, UV llampa, bateri per UV llampa, vula, furnizimi i zyrtarve të SKQZ-se me të gjitha materjalet e nevojshme administrative. Gjatë kësaj periudhe, nga

Zyrtaret e Përkthimit në gjuhë serbe dhe angleze, janë përkthyer këto dokumente: rendi i ditës materialet, vendime, dokumentet e ndryshme për takimet e Këshillave dhe takimet e KQZ-se, dhe komunikatat dhe njoftimet për ueb faqen e KQZ-se për media, si dhe përkthimet simultane dhe materialet tjera zyrtare që kanë të bëjnë me takimet e KQZ-së.

Zyra për Regjistrimin e Partive Politike, e informoi KQZ-në për konfirmimin e PZAP-së për borgjet e mbetura të Subjekteve Politike nga zgjedhjet Lokale 2009, deri te zgjedhjet e Jashtëzakonshme për dy komunat (Ferizaj dhe Kaçanik), që u mbajtën gjatë vitit 2012. Gjithashtu, Zyra e informoi KQZ-në edhe për Draftvendimin për transferimin e mjeteve nga Fondi për subjektin AAK në xhirollogarinë e PZAP, si borxh i mbetur nga zgjedhjet komunale në Kaçanik.

Në vazhdim të mbledhjes, Alban Krasniqi, nuk e paraqiti raportin e KOZ-it. Në ndërkohë, kryetarja Valdete Daka, tha se, për shkak të gabimeve të bëra në Formularë, ka urdhëruar tërheqjen e tyre nga Ueb faqja, deri në përmirësim teknik. Kërkesa për heqjen e formularëve të votimit përmes postës, është bërë për arsye se të njëjtit, në përkthim nga gjuha shqipe në atë serbe kanë gabime, dhe për këtë duhet të përmirësohen si dhe në ata formularë, duhet të jepen informata me të detajzuara për votuesit dhe pastaj, të vendosen numrat identifikues për secilin. Gjithashtu, anëtarët e KQZ-së, e miratuan vendimin për transferimin e mjeteve lidhur me gjobën e subjektit politik, AAK.

Raportin e KOZ-it, e paraqiti Betim Gjoshi. Ai, prezantoi listën prej tre emrash për zëvendësime e KKZ-ve nga komunat në Drenas dhe në Shtërpce. Rasti i Drenasit, kishte të bënte me mosplotësim të kriterëve ligjore, dhe për këtë ishte dhënë afati shtesë. Prandaj, anëtarët e KQZ-së, emëruan Albert Ramajn, anëtar të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) për zgjedhjet lokale të 03 nëntorit 2013, nga Subjekti Politik “Lëvizja Vetëvendosje”. Gjithashtu, KQZ, miratoi edhe rekomandimin e KOZ-it-it për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit Komunale të Zgjedhjeve (KKZ) në Shtërpce, për zgjedhjet lokale 2013, sipas kërkesës të subjektit politike “JSL”, si në vijim: 1. Zvezdan Spasic, u zëvendësua me Dragan Radivojeviqin, nga subjekti politik “JSL” në Shtërpce.

Në vazhdim, KQZ miratoi edhe zëvendësimin e Kujtim Balen, anëtar i deritashëm i Kuvendit Komunal të Pejës, nga subjekti politik “Partia e Drejtësisë” (PD), me Adem Goranin. Anëtarët e KQZ-së, u informuan pastaj, edhe lidhur me projektin “K-vote”. Betim Gjoshi, tha se, ky projekt është testuar në Kaçanik dhe Ferizaj, dhe rezultatet janë dhënë drejtpërdrejt. Projekti është i gatshëm, dhe rekomandojmë që të aprovohet. Gjithashtu, u diskutua edhe *njoftimi lidhur me përmbajtjen e softuerit të QNR-së*. KQZ, miratoi Projektin e Rezultateve Preliminare “K-Vote 2013” për zgjedhjet lokale, që do të mbahen më 03 nëntor 2013, di dhe i dha mbështetje Softuerit në Qendrën e Numërimit dhe të Rezultateve (QNR).

Këshilli për Buxhet dhe Prokurim, e informoi KQZ-në lidhur me rishikimin e buxhetit të planifikuar për Fletëvotimet e ID-ve të KVV-ve. Ilir Gashi, tha se, në bazë të vendimeve të KQZ-së për rishikime, çështja lidhet me Fletëvotimet dhe ID-kartat. Këto kërkesa, kanë pas disa implikime buxhetore. Do të ketë mjete shtesë për këto projekte.

Këshilli për Procedura, e informoi KQZ-në lidhur me shqyrtimin e Draft përgjigjes për Subjektin Politik “LDK”, dega në Gjilan dhe në Kamenicë, sepse ata kanë bërë ankesë lidhur me propozimet për KKZ-të. Bajram Ljatifi, kryesues i KP-së, tha se është nxjerrë përfundimi se, dy kuti nga këto dy komuna janë në Karantinë, dhe se këta persona, nuk mund të angazhohen në procesin zgjedhor. Ata, janë refuzuar dhe, janë miratuar të tjerë persona. Të dy këto ankesa, janë refuzuar. Në kontekst, kryetarja Valdete Daka, tha se, KQZ nuk do t'i angazhojë në zgjedhje personat që në të kalaurën në çfarëdo mënyre, janë të hetuar. Florian Dushi, anëtar i KQZ-së, tha se, pavarësisht që bëhet fjalë për LDK-në, të nominuarit e këtij subjekti refuzohen dhe ky është një standard, mirëpo KQZ duhet t'i ketë të gjitha informacionet nga institucionet relevante që, pavarësisht se për cilin subjekt bëhet fjalë, asnjë person që në çfarëdo forme të ketë manipuluar të mos emërohet në asnjë mënyrë. Pra, KQZ duhet t'i ketë listat nga Këshilli Gjyqësor, nga Prokuroria, nga PZAP dhe listën nga QNR. Nominimet

e ardhshme, duhet t'i nënshtrohen një kontrolli të rreptë. Betim Gjoshi, tha se, KQZ ka bërë përpjekje si institucion edhe në të kaluarën për të vendosur standarde në këtë drejtim, dhe e përkrahi çdo vendim që fuqizon këto standarde.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në kontekst të Draftpërgjigjes për Subjektin Politik "JSL", debatoi edhe rreth kriterëve për financimin e partive politike, problemet që paraqiten etj. Ndërkaq, anëtarët e KQZ-së, konstatuan se, nuk janë të autorizuar të kthejnë përgjigje në këtë kërkesë.